



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr. 801 Prot.

Tiranë, më 28. 05.2026

V E N D I M

Nr. 132, Datë 28. 05.2026

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, mori në shqyrtim ankesën nr.107 Regj., datë 23.04.2026”, të F. B., kundër Drejtorisë Rajonale Sigurimeve Shoqërore Durrës, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit ankuesi, ka parashtruar si vijon: *Unë F. M. B., punësohem në një nga institucionet e Republikës së Shqipërisë, OSHEE Durrës me adresë KNK 1 Durrës, Rr e Doganës. Punësimi im daton më 08.04.2021 deri më 30.09.2024. Periudha të cilat shkonte çdo gjë mirë deri sa më vjen 30.09.2024 më kontaktojnë nga DRSSH Durrës (Drejtoria Rajonale Sigurimeve Shoqërore Durrës) dhe më vënë në dijeni për një debi me vlerë 1276758 lekë të reja. Shkak i kësaj debie është si pasojë e punësimit tim pasi unë trajtohem me (KMCAP). Dhe në punë kam qenë i punësuar me kohë të plotë. Dhe gjatë kësaj periudhe të gjatë kohore pothuajse gati 4 vjet mua nuk më është kontaktuar asnjë informacion nga të dy institucionet që më kanë rënduar psikologjikisht dhe ekonomikisht. I ndodhur para këtij fakti detyrohem të jap dorëheqen nga puna me datë 03.12.2024. Nga dita e parë që jam dorhequr nga puna e deri më ditët e sotme*

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Invalid i përhershëm sipas Librezës së Invaliditetit nr. 14050/

³Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

mu më mbahet çdo muaj një debi nga pensioni im me vlerë 9461 të reja, debi e cila do të zgjas për 12 vjet.

Masat që kërkohen nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: Konstatimin e diskriminimit dhe zgjidhni këtë problem ekonomik, psikologjik i cili po rëndon çdo ditë në jetesën dhe familjarëve e tij.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1, të LMD përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të LMD, diskriminimi përcaktohet si : “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Bazuar në nenin 7, pika 1, të LMD, përcaktohet se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

Bazuar në nenin 33, pika 1, të LMD, përcaktohet se: “1. Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal.”

Bazuar në nenin 32, pika 3, të LMD, përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

Bazuar në nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;”

Bazuar në nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës dhe mbështetur në faktet dhe pretendimet e parashtruara nga ankuesit, Komisioneri vlerëson se bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b” të LMD, ku përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.....”, ankesa objekt shqyrtimi nuk duhet të pranohet si e papajtueshme me dispozitat e ligjit, për arsyet e mëposhtme:

Objekt i ankesës së paraqitur nga z. F. M. B., është kundërshtimi i detyrimit financiar (debi) në shumën 1,276,758 lekë, të cilin ai pretendon se i është vendosur në mënyrë të padrejtë, si pasojë e përfitimit të pensionit të invaliditetit gjatë periudhës së punësimit. Njëkohësisht, ankuesi kërkon konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave për zgjidhjen e pasojave ekonomike dhe psikologjike të shkaktuara nga kjo situatë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se:

- Ankuesi është përfitues i pensionit të invaliditetit të plotë që prej datës 28.10.2009, sipas vendimit të KMCAP dhe librezës së invaliditetit nr. 14050.
- Ai është vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme nga KMCAP si i paaftë për çdo veprimtari ekonomike dhe me nevojë për kujdes të vazhdueshëm.
- Ankuesi ka qenë i punësuar me kohë të plotë pranë OSHEE Durrës në periudhën 08.04.2021 – 30.09.2024.
- Gjatë kësaj periudhe ai ka përfituar njëkohësisht edhe pension invaliditeti të plotë.
- Në vijim, nga verifikimet e kryera nga DRSSH Durrës, është konstatuar përfitimi i padrejtë dhe është krijuar një detyrim (debi) në shumën 1,276,758 lekë.
- Ankuesi është njoftuar për këtë detyrim dhe aktualisht i mbahet këst mujor nga pensioni.
- Situata i është sqaruar ankuesit edhe nëpërmjet shkresës nr. 13744/1 prot., datë 16.10.2025, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës.

Sistemi i sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i rregulluar nga ligji nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbështetet mbi parimin kontributiv, sipas të cilit përfitimet financiare kanë për qëllim të zëvendësojnë të ardhurat e humbura si pasojë e pamundësisë për punë. Ky parim përbën themelin e gjithë skemës, duke krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë midis kontributeve të paguara, gjendjes së paaftësisë dhe masës së përfitimit. Në këtë kuptim, përfitimi nuk është një e drejtë absolute, por një e drejtë e kushtëzuar nga plotësimi i kriterëve ligjore dhe nga ekzistenca reale e mungesës së të ardhurave për shkak të paaftësisë për punë.

Në mënyrë të veçantë, neni 57 i këtij ligji sanksionon një nga kufizimet kryesore të skemës, duke përcaktuar se përfituesi nuk ka të drejtë të marrë këste përfitimi për çdo periudhë gjatë së cilës është i punësuar ose ushtron veprimtari ekonomike, qoftë si i punësuar apo i vetëpunësuar. Kjo dispozitë nuk lë hapësirë për interpretim alternativ, pasi synon të shmangë përfitimin e dyfishtë dhe të

garantojë që skema të funksionojë mbi bazën e drejtësisë dhe barazisë ndërmjet përfituesve. Vetëm në raste të veçanta, të parashikuara shprehimisht nga ligji, siç është invaliditeti i pjesshëm, lejohet kombinimi i kufizuar i përfitimit me aktivitetin ekonomik, pikërisht sepse në këto raste personi nuk është plotësisht i paaftë për punë.

Nga ana tjetër, dispozitat e neneve 35 dhe 48 të ligjit përcaktojnë qartë natyrën dhe kushtet e përfitimit të pensionit të invaliditetit të plotë. Sipas këtyre dispozitave, ky pension u takon personave që janë të paaftë për çdo veprimtari ekonomike, pra që nuk kanë mundësi reale për të siguruar të ardhura përmes punës. Ky përcaktim nuk është thjesht formal, por lidhet drejtpërdrejt me vlerësimin mjekësor të bërë nga KMCAP, i cili konstaton shkallën e humbjes së aftësisë për punë. Për rrjedhojë, statusi i invaliditetit të plotë përjashton në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë mundësinë e ushtrimit të një pune të rregullt, pasi vetë përfitimi jepet pikërisht për shkak të pamundësisë për të punuar.

Në këtë kuadër, këto dispozita, të marra së bashku, krijojnë një regjim të qartë juridik: përfitimi i pensionit të invaliditetit të plotë është i lidhur ngushtë me mungesën e aktivitetit ekonomik dhe ndërpritet automatikisht në momentin kur kjo mungesë nuk ekziston më.

Në këto kushte, në analizë të kuadrit ligjor të sipërcituar, rezulton se për sa kohë ligjvënësi, nëpërmjet ligjit nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, ka parashikuar në mënyrë të qartë kushtet, kriteret dhe kufizimet për përfitimin e pensionit të invaliditetit, përfshirë edhe ndalimin e përfitimit të tij në rastet e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, atëherë institucionet përgjegjëse janë të detyruara të zbatojnë këto dispozita në mënyrë të detyrueshme dhe të njëtrajtshme.

Po kështu, edhe ndërhyrjet e mëparshme të ligjvënësit, si ligji nr. 72/2017 për faljen e detyrimeve deri në një moment të caktuar kohor, tregojnë se çdo lehtësim apo përjashtim nga ky regjim bëhet vetëm me akt ligjor dhe jo në mënyrë diskrecionale nga institucionet zbatuese.

Në këto kushte, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës ka vepruar në përputhje me detyrimet ligjore, duke zbatuar dispozitat në fuqi dhe duke ndërmarrë masat përkatëse për identifikimin dhe rikuperimin e përfitimeve të marra pa të drejtë, pa pasur kompetencë për të shmangur apo ndryshuar zbatimin e tyre.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe për rrjedhojë ankesa nuk duhet të pranohet për t’iu nënshtruar procedurave të mëtejshme për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, nenin 32, pika 3, nenin 33, pika 1 dhe pika 4, gërma “b”, nenin 33 pika 10 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenin 3, pika 7 dhe 8, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës me nr.107 Regj., datë 23.04.2026”, të F. B., kundër Drejtorisë Rajonale Sigurimeve Shoqërore Durrës, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*aftësisë së kufizuar*”, pa një vendim përfundimtar për çështjen, për arsye se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Genta Tafa (BUNGO)